

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI PËR ÇËSHITJE EKONOMIKE, me gjyqtarin **Murat Paçarada**, duke vendosur në çështjen juridike-kontestimore të paditësit "Ndërmarrja Export-Import" D. D.", B. Ll., Republika B. dhe H., me nr. Biznesi *numër i biznesit...*, me drejtor P. R., e përfaqësuar sipas autorizimit nga V. B. avokate nga P., kundër të paditurit "Sh.p.k."P. C.", me nr. Biznesi *numër i biznesit...*, Distributor F. K. nga L., Komuna e P., i përfaqësuar sipas autorizimit nga N. Q., avokat nga P., për shkak të borxhit, vlera e kontestit 17.168,95 €, me datën 02.09.2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Ndermarrja Expost-Import "D. D.", me seli në B. Ll., Republika B. e H., ashtu që detyrohet i padituri Sh.p.k., "P. C.", me seli në L., Komuna e P., që paditësit në emër të borxhit t'ia paguajë shumën prej 17.168,95 €, me kamatën ligjore prej 3.5% duke filluar nga data e parashtrimit të padisë, parkatësisht data 10.11.2014, e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

II. Detyrohet i padituri që në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia paguaj paditësit dhe atë për padi vlerën prej 86, për aktgjykim vlerën prej 86, për përfaqësime në 3(tri) seanca gjyqësore vlerën prej shumën prej 811,20 €, (270.40x3), gjithsej shumën e përgjigjshme prej 983,00 euro, brenda afatit prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Rrethanat procedurale të çështjes

Paditësi "Ndërmarrja Export-Import" D. D.", B. Ll. nga B. e H., me datë 10.11.2014, në këtë Gjykatë ka ushtruar padi, kundër të paditurit Sh.p.k., "P. C.", Distributor F. K. nga L., Komuna e P.. Ndër të tjera në padi ka cekur se paditësi me të paditurën me datën 20.08.2010 kanë lidhur kontratë me nr.510 dhe aneksin e saj nr.211, ku paditësi është paraqitur në cilësi të shitësit ndërsa i padituri në cilësi të distributorit, me ç'rast shitësi ka pasur interes që të distriboj mallin në territorin e Kosovës dhe distributori u angazhua që ta kryente këtë shërbim. Kanë pasur marrëdhënie tregtare të vazhdueshme duke u bazuar në kontratë, deri sa e paditura nuk e përmbushi të njëjtën dhe se shumën e kësaj llogarie për produktet e pranuar nuk e ka paguar duke i mbetur borxh paditësit. Edhe pas kërkesës nga ana e paditësit për pagimin e borxhit i padituri nuk i ka kryer obligimet e mara, andaj ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit dhe të detyrohet i padituri që paditësit në emër të borxhit dhe fitimit të humbur t'ia paguaj shumën prej 17.168,95 euro, duke llogaritur interesin bankar sipas afatizimit një vjeçarë, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

I padituri Sh.p.k., "P. C.", nga L., me datë 15.04.2016, ka paraqitur përgjigje me shkrim në padi me të cilën e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia. Ndër të tjera ka theksuar se nga provat e bashkangjitura në padi nuk është e qartë se çfarë në të vërtetë po kërkon paditësi dhe cila është kërkesa e tij. Nuk është kontestuese fakti se paditësi me të paditurin kanë pasur raporte kontraktuale në bazë të kontratës, mirëpo kontestuese është fakti se a i ka borxh ose jo e paditura paditësit dhe mbi cilën bazë paditësi pretendon në

këtë borxh dhe fitimin e humbur. Ka theksuar se sipas dispozitave të LMD-së kemi të bëjmë me parashkrim sepse kërkesa për borxh ka të bëjë për periudhën 2010-2011 ndërsa padia është bërë në vitin 2014. I ka propozuar gjykatës që të vlerësojë afatshmërinë e kërkesës dhe njëherit ta vlerësojë edhe në aspektin formal padinë dhe se petitumi i të njëjtës është i paqartë duke cekur faktin se i padituri nuk ka asnjë obligim ndaj paditësit, andaj kërkon që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të hudhet poshtë osë që të njëjtën t'ia kthejë në përmirsim paditësit, në të kundërtën ka kërkuar që të refuzohet e pa bazë.

Paditësi me parashtresën e dt.05.05.2016, ka paraqitur kundërshtim të përgjigjes në padi të paditurit, duke theksuar se meqë i padituri e konteston ekzistimin e borxhit atëherë të ofroj kundërproven me të cilën do të vërtetohet se i njëjti e ka kryer obligimin ndaj paditësit, dhe njëherit ka cekur se nuk kemi të bëjmë me parashkrim meqë kërkesa rrjedh nga viti 2012, e sipas LMD-së në fuqi kërkesat për detyrim parashkruhen në afat prej 5 vitesh, rrjedhimisht shihet se padia është ushtruar në vitin 2014, që do të thotë se nga borxhi i fundit kanë kaluar një vitë, dhe nëse e marrim edhe supozimin e palës së paditur 2012 atëherë kanë kaluar vetëm dy vite.

Në seancën pregaditore të mbajtur pranë kësaj gjykate me dt.03.06.2016, përfaqësuesja e paditësit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kërkesëpadiës dhe pranë kundërshtimit të përgjigjes në padi të bërë me dt.05.05.2016, duke propozuar që për seancën e radhës të dëgjohen si palë në procedurë përfaqësuesi i paditësit M. B. nga B. Ll., R. B. e H., ndërsa në cilësi të dëshmitarit të dëgjohet i padituri, F. K.. Në i kemi dorëzuar gjykatës e-maillet me anë të së cilave paditësi ka kërkuar në vazhdimsi nga i padituri përmbushjen e detyrimit.

Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën e dt.03.06.2016, ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë përgjigjes në padi duke i propozuar gjykatës që fillimisht ta shqyrtojë afatshmërinë e padisë në kuptim të nenit 374 të LMD-së. Nuk e kundërshtoj dëgjimin e palëve të propozuara nga paditësi, kërkoj nga gjykata që të më jep një afat që me parashtresë të dorëzojë dy kopje si prova materiale, faturat me të cilat do të vërtetohet se një pjesë e borxhit është përmbushur.

Gjykata me aktvendim ka aprovuar propozimin e përfaqësueses së paditësit që për seancën e dt.13.07.2016, të ftohet M. B. nga B. Ll., R.B.e H., në cilësi të dëshmitarit, dhe në cilësi të dëshmitarit të dëgjohet F. K..

Në seancën kryesore të mbajtur pranë kësaj gjykate me dt.13.07.2016, përfaqësuesja e paditësit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadiës ashtu që kërkoj nga gjykata që të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Përfaqësuesi i palës së paditur në seancën kryesore të dt.17.03.2016, ka deklaruar se mbetet në tërësi si në përgjigje në padi, si dhe nga deklaratimet nga seancat e kaluara, ndërsa sa i përket obligimit që kam marrë nga aktvendimi i dt.03.06.2016, e njoftoj gjykatën se nuk posedojë prova të tjera.

Në seancën e datës 13.07.2016 të mbajtur pranë kësaj gjykate, në pyetjet e parashtruara nga ana e palëve ndërgjygjëse dëshmitari M. B., nga B. Ll., R. B. e H., ka deklaruar se me të paditurin kemi zhvilluar raprote afariste të cilat kanë qenë korrekte duke u bazuar në kontratën e lidhur deri më tani nuk kemi pasur vërejtje në dërgimin e mallit. I padituri nuk e ka arsyetuar asnjëherë mos pagesën e borxhit dhe se ne disa herë kemi tentuar që të kontaktojmë me të paditurin përmes telefonit dhe e-maileve ku posedojmë edhe prova për këtë. Më tej dëshmitari ka theksuar se rabati prej 10% i cili ishte i paraparë në aneks kontratën e dt.20.08.2010, është zbatuar edhe në faturat kontestuese, mirëpo pala e paditur ka pasur për obligim që rabati prej 10% paraprakisht të na njoftojë se ku e ka investuar që ne më pastaj ta njohim përkatësisht t'ia kompensojmë. Duke pasur parasysh raportet e mira afariste me të paditurin ne kemi reaguar me vonesë për ta kërkuar borxhin. Unë nuk kam njohuri se cilat kanë qenë përfitimet e të paditurit, dhe sa i përket interesit se a e ka marrë i padituri për distribuimin e mallit, i njëjti përgjigjet se ne nuk kemi kurrfar obligimi për shërbimet e distribuimit nga se të njëjtin e kalkulojmë vetë.

Në seancën e dt.13.07.2016, të mbajtur pranë kësaj gjykate, në pyetjet e parashtruara nga ana e palëve ndërgjygjëse dëshmitari F. K., ka deklaruar se raportet e biznesit në mes të paditësit dhe të paditurit kanë qenë shumë të mira mirëpo, pasi që ndodhi reciprociteti me shtetin e B. dhe H. nuk ka pasur punë dhe pala paditëse kishte vendosur që ta ndërroj distributorin dhe për këtë më kanë njoftuar. Meqë e kanë ndërruar desitributorin paditësi më ka premtuar se do ta bëjë dëmshpërblimin mirëpo nuk e di se a e kanë bërë këtë dëmshpërblim ngase kam qenë i ngarkuar me disa telashe të tjera. Firma "P. C." më nuk punon ngase kam falimentuar. Më tej ka deklaruar se unë nuk kam ra në vonesë, por pagesa nuk është bërë ngase paditësi ka kërkuar që unë të punojë më shumë, mirëpo pasi ka gjetur një distributor më të mirë e ka shkëputur kontratën, ndërsa sa i përket mallit të faturuar ka theksuar se unë e kam marrë këtë malli, e që më vonë kompania E. e ka marrë krejt këtë mall dhe se për të njëjtin na është bërë pagesa ne dhe jo paditësi, mirëpo nuk e di nese këto para a i janë dërguar ndërmarrjes "D." ngase me ato punë është marrë kontabilisti. Ndërsa në pyetjet e parashtruar nga gjykata i njëjti është përgjigjur se unë nuk jam i njoftuar se për mos pagesë jemi thirrur në të metat e mallit dhe se nuk jam në dijeni nese vërtet ekziston borxhi, për këtë se a ekziston borxhi apo jo ndaj firmes "D." më së miri mund ta dij Sh.B. me pastaj deklaroi se biznesi i tij është i regjistruar si sh.p.k., mirëpo ma ma firma nuk ekziston, ende nuk e kam çregjistruar në ARBK.

Gjendja faktike e konstatuar

Në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata ka bërë administrimin e provave të lëndës, si në vijim: aneks kontrata me nr.511/10 e dt.20.08.2010; kontrata mbi distribuimin e dt.20.08.2010; fatura nr.IZ-34/11;kartela financiare e blersit,e datës 31.12.2013; fatura nr.1-1653511 me nr fiskal *numër fiskal...*; fatura DUD-i me nr.400842150003; e-maillet e dt.28.04.2016 ora 12,12 min., 12,26 minuta., 12,13 minuta.

Përfaqësuesja e paditësit në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se pas shqyrtimit të këtyre provave në gjykatë dhe dëgjimit të palëve në procedurë , u vërtetua në mënyrë të qartë se e paditura nuk e ka paguar borxhin kontestues paditësës dhe nuk e ka sjellë asnjë provë në gjykatë që do mund ta kundërshtonte provën e paditësës se i njëjti nuk e ka paguar borxhin siç ishin faturat të cilat janë administruar si prova.E paditura e pranoj se e ka marrë mallin dhe se e ka dorëzuar te firma “E.” të cilët e kanë bërë pagesën e mallit mirëpo pagesa e atij malli nuk i është dorëzuar këtu paditësit me arsyetimin se ka pasur telashe, për arsye te ekzistimit të reciprocitetit,çështje këto që nuk kanë të bëjnë me objektin e kontestit ngase nuk është kontestuese që ata kishin marrëveshje tregtare të nënshkruar me vullnetin e palëve kontraktuese. Andaj i ka propozuar gjykatës që të aprovojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar si dhe i kërkon shpenzimet e procedurës sipas T.A dhe atë në emër të tri(3) seancave gjyqësore, prej 1.000,00 euro.

Përfaqësuesi i të paditurit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara dhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore nuk është arritur të vërtetohet se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar për arsye si në vijim;është fakt që në mes tyre nuk u kontestua që ka ekzistuar kontrata e lidhur në vitin 2010 sipas të cilës paditësi e ka furnizuar me mall të paditurin,ku në nenin 8 të kësaj kontratë janë paraparë afatet e pagesës.

Eshtë paditësi ai që e ka shkëputur kontratën për distribuim dhe më këtë i ka shkaktuar dëm të paditurit dhe e ka ngarkuar me fatura të cilat nuk janë të rregullta për arsye se të njëjtat nuk përshtaten në vlerë me deklaratat unike DUD-id që janë të administruara si provë. Nuk i posedoj faturat origjinal dhe nuk e di të njëjtat a i ka gjykata , po të ishin në rregull këto fatura nuk ka pa pasur nëvojë që paditësi të ushtroj padi në gjykatë nga se ka mundur të benë propozim për përmbarim. Andaj i propozojë gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pa bazë mbi faktin se barra e të provuarit bie mbi paditësin e cila nuk ka arritur të vërtetojë së në çfarë mënyre është tërhequr malli, me urdhër të kujt, kush e ka paguar paguar këtë mallë etj.Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë 150,00 për përpilimin e përgjigjies në padi, 200,00 euro për seancë duke përfshirë edhe shpenzimet e udhëtimit, gjithsej shumë e përgjigjthshme prej 750,00 euro.

Gjykata, duke vlerësuar me ndërgjegje secilën provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku, konform nenit 8 të LPK-së, si dhe faktet jo kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse, konstatoi këtë gjendje të fakteve:

- Padiësi dhe i padituri kanë lidhur kontratë për furnizimin e të paditurit me mallra, ndërsa e padituri ka marrë detyrimin e pagimit të çmimit të mallrave të pranuar.
- Padiësi për mallrat e dorëzuara ka lëshuar edhe fatura.
- I padituri i ka pranuar mallrat ushqimore nga padiësi, po ashtu i ka nënshkruar faturat e lëshuara nga padiësi në mënyrë të rregullt mbi pranimin e mallit.
- Eshtë jo kontestuese se në bazë të kartelës financiare të datës 31.10.2013, të të paditurit, padiësi ja ka dërguar mallin në vlerë prej 17.168.95€.
- Eshtë jokontestuese se mallin i cili ka qenë në depon e të paditurit e ka marrë firma “E.”
- Eshtë jo kontestuese se pagesa nga firma “E.” për këtë mall i është bërë të paditurit, të cilën e pranon edhe vet pronari-përfaqësues ligjor në deklaratën e tij si dëshmitar.

- Çështje kontestuese në mes të palëve në procedurë ka qenë fakti se a i ka paguar i padituri të gjitha faturat për mallrat e pranuar. Padiësi ka pretenduar se i padituri nuk i ka paguar.

- Duke u bazuar në provat e lartcekura, dhe sidomos nga faturat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, gjykata ka vërtetuar faktin se pala e paditur, ka pranuar mallra nga padiësi. I padituri nuk e ka bërë pagesën e një pjese të këtyre faktuarve. Pas shqyrtimit të faturave të papaguara, e posaqërisht kartelës financiare të blersit, si dhe dëshmisë së pronarit të të paditurës në cilësinë e dëshmitarit e cila e ka pranuar se mallin e ka paguar firmën “E.” në llogari të sajë, gjykata ka vërtetuar faktin se borxhi aktual të cilin e paditura i ka padiësit është në shumën prej 17.168,95 €.

Baza juridike e kërkesëpadisë

Me nenin 17.1. të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së), është e përcaktuar se pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre. Ndërsa në dispozitat e nenit 262 par.1. të LMD-së, është e përcaktuar se kreditori në raporte detyrimore është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori është përgjegjës ta përmbushë detyrimin e tij në mënyrë të ndërgjegjshme. Megjithatë padiësi ka lëshuar fatura për borxhin në fjalë, i padituri nuk ka kryer plotësisht pagesat lidhur me borxhin në fjalë, gjë që ka shkelur detyrimet e tij kontraktuese dhe ligjore. Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartcekura, dhe konform dispozitave ligjore të cituara më lartë, gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadia e padiësit është e bazuar dhe si të tillë e ka miratuar.

Gjykata e miratoi kërkesëpadinë edhe përkitazi me kamatën e vonës së kërkuar, ashtu që e detyroi të paditurin që përveç borxhit kryesor, padiësit t’ia paguajë edhe kamatën ligjore siç e paguajnë bankat në Kosovës, për deponimet prej një viti, pa destinim të caktuar, e cila fillon të rrjedh nga dita e ushtrimit të padisë, gjegjësisht data 10.11.2014, e deri në pagesën definitive, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së.

Shpenzimet procedurale

Neni 449 par.1 dhe 2 është përcaktuar se çka përfshijnë shpenzimet procedural, andaj gjykata ka vendosur edhe për shpenzimet e shkaktuara në procedurë konform neni 452 par. 1 të LPK-së, dhe konform tarifës së Odes së Avokateve të Kosovës ku palës paditëse i janë miratuar, shumat si në vijim: ne emër të padisë shuma prej 86,00 €, ne emër të taksave gjyqësore për aktgjykim shuma prej 86,00 €, honorari i avokatit në shumën prej 811,20 €, (270.40x3), gjithsej shumën e përgjigjshme prej 983,00 euro €.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Ekonomike

IV.C.nr.566/14, datë 02.09.2016

Gjyqtari

Murat Paçarada

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.